



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No	21-57
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-03-
Prishtinë / a	
Datum: Date: 08/01/2021	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr.17/I/2021
Datë:08.01.2021

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), në zbatim të nenit 89 të Ligjit nr. 04/1-125 për shëndetësi, në zbatim të Nenit 4, nenit 5 paragrafi 2.5, Nenit 12 paragrafit 4, Nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit nr. 07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcës 7 të Rregullores Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr.01/51, datë 22/12/2020, në zbatim të rekomandimeve të IKSHPK-së me qëllim të kontrollit dhe parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19, nxjerrë:

V E N D I M

1. Miratohen masat e veçanta për mbrojtjen nga pandemia COVID-19, në **Komunën e Gjilanit**.
2. Masat e miratuara në Komunën e **Gjilanit** janë si më poshtë:
 - 2.1. Operatorët ekonomik lejohen të punojnë nga 05:00-20:00,
 - 2.2. Qendrat tregtare lejohen të punojnë nga 05:00-20:00,
 - 2.3. Shërbimet e hotelerisë dhe gastronomisë lejohen të punojnë nga 05:00-20:00, ndërkaq pas orës 20:00 punojnë me shërbim "merr me vete" dhe "porosi me dërgesë",
 - 2.4. Transporti publik lejohet të punoj duke shfrytëzuar deri në 50% të kapaciteteve, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
 - 2.5. Taksitë lejohen të punojnë me një (1) pasagjer prapa ose deri në tre (3) nëse janë anëtarë të familjes, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
 - 2.6. Institucioneve vartëse të MKRS dhe komunave (siç janë teatrot, bibliotekat, filarmonia, galeritë, ansamblet, baleti, kinematë, qendrat rinore, muzetë, qendrat e kulturës me grupe dhe të ngjashme), lejohet të punojnë vetëm deri në orën 20:00 duke shfrytëzuar deri në 30% të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse për të gjitha aktivitetet (si në shfaqje ashtu edhe në ushtrime), duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",

- 2.7. Lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura dhe të hapura, ku gjatë stërvitjeve në hapësirat e mbyllura mund të marrin pjesë deri në 20 persona, ndërsa gjatë garave deri në 50 persona, gjithmonë bazuar në protokolle vendore dhe ndërkombëtare sportive, si dhe duke u bazuar në "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
 - 2.8. Lejohen fitneset dhe pishinat e mbyllura për aktivitete individuale rekreative duke shfrytëzuar deri në 40% të hapësirave/sipërfaqeve, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
 - 2.9. Pavarësisht pikave 2.6, 2.7 dhe 2.8 më lartë, autorizohet Ministria e Shëndetësisë që bazuar në rekomandimet e IKSHP-së të nxjerrë vendime operacionale të ndalojë këto aktivitete.
3. Dështimi në respektimin e këtyre masave në çdo rast, i nënshtrohet masave ndëshkimore në përputhje me Ligjin nr.07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës nga ana e Institucioneve përgjegjëse të cilat janë të obliguara të mbikqyrin dhe të sigurojnë zbatimin e këtyre masave.
 4. Ky vendim vlenë deri në një vendim tjetër, bazuar në situatën epidemiologjike në vend;
 5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

A r s y e t i m

Në bazë të vlerësimeve dhe rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, meqenëse Komuna e **Gjilanit** kategorizohet me rrezik të ulët të infeksionit, me qëllim të mbrojtjes së popullatës nga COVID-19, për të parandaluar përkeqësimin e gjendjes së menaxhimit të mjekimit nga institucionet shëndetësore lidhur me kapacitetet spitalore për trajtim, Ministri i Shëndetësisë në zbatim të Ligjit nr. 07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Armend Zemaj**
Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;
- Komunës së **Gjilanit**;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zëvendësministrave të Msh;
- IKSHPK-së;
- Policisë së Kosovës;
- Inspektoratit sanitar;
- Inspektoratit shëndetësor dhe Inspektoratit farmaceutik;
- Inspektorateve komunale;
- Departamenti ligjor;
- Divizionit për komunikim me publikun;
- QOE-Msh;
- Sekretarisë së Komitetit për Covid-19;
- Arkivit të MSh.